



OPEN BANKING, ZHVILLIMET E TREGUT, SFIDAT DHE PRESPEKTIVA PËR VITIN 2024

DENIZ DERALLA

DREJTOR I DEPARTAMENTIT TË MBIKËQYRJES

TIRANË, 13 DHJETOR 2023

RREGULLORJA 29/2022 “PËR AUTENTIFIKIMIN E THELLUAR TË KLIENTIT DHE STANDARDET E PËRBASHKËTA, TË HAPURA DHE TË SIGURTA TË KOMUNIKIMIT”

U miratua në 01.06.2022

Hyn në fuqi 01.01.2024

19 muaj për zhvillimin e Open API


Rregullorja synon përcaktimin e kërkesave për:

- vendosjen e **standardeve të përbashkëta, të hapura dhe të sigurta të komunikimit** ndërmjet ofruesve të shërbimit të pagesës për shërbimin e llogarisë, ofruesve të shërbimit të inicimit të pagesës, ofruesve të shërbimit të informimit të llogarisë, paguesve, përfituesve të pagesës dhe ofruesve të tjerë të shërbimeve të pagesave, në lidhje me ofrimin dhe përdorimin e shërbimeve të pagesave;
- zbatimin e procedurës së **Autentifikimit të Thelluar të Klientit** dhe **rastet e përjashtimit nga zbatimi i kërkesave të sigurisë së autentifikimit të thelluar të klientit**, bazuar në nivelin e rrezikut, shumën dhe përsëritjen e transaksionit të pagesës, si dhe të kanalit të pagesës të përdorur për ekzekutimin e tij;
- **mbrojtjen e konfidencialitetit dhe integritetit të kredencialeve të personalizuarra të sigurisë** së përdoruesve të shërbimeve të pagesave.

SUBJEKTET E RREGULLORES


- Ofruesit e shërbimeve të pagesave që parashikohen në ligjin “Për shërbimet e pagesave”:
 - Bankat
 - Institucionet e Pagesave
 - Institucionet e Parasë Elektronike
- Ligji “Për shërbimet e pagesave” prezantoi konceptin e ofruesit të shërbimit të inicimit të pagesës dhe ofruesit të shërbimit të informimit të llogarisë, si palë të rëndësishme në Open Banking.
- Gjithashtu u prezantua koncepti i ofruesit të shërbimit të pagesës për shërbimin e llogarisë – si një ofrues i shërbimit të pagesës që siguron e mirëmban një llogari pagese për paguesin.

OFRIMI I SHËRBIMIT TË INICIMIT TË PAGESËS:



- Përdoruesi i shërbimeve të pagesave që po blen një produkt nga tregtari, urdhëron ofruesin e shërbimit të inicimit të pagesës (PISP) që të iniciojë pagesën.
- PISP komunikon në mënyrë të sigurt dhe inicion transaksionin e pagesës së përdoruesit te tregtari, nga llogaria e pagesës e mbajtur te ofruesi i shërbimeve të pagesës së përdoruesit (psh.banka).
- Ofruesi i shërbimeve të pagesës së përdoruesit (psh.banka) ekzekuton transaksionin e pagesës të iniciuar nga PISP në emër të përdoruesit, te banka e tregtarit.
- PISP i konfirmon tregtarit që pagesa është iniciuar dhe ky i fundit dorëzon produktin te blerësi.

OFRIMI I SHËRBIMIT TË INFORMIMIT TË LLOGARISË:



- Përdoruesi i shërbimeve të pagesave autorizon ofruesin e shërbimit të informimit të llogarisë (AISP), të aksesojë llogaritë e tij të pagesave të mbajtura nga një ose disa ofrues të shërbimeve të pagesave.

- Ofruesi i shërbimit të informimit të llogarisë (AISP), akseson në mënyrë të sigurt informacionin mbi llogaritë e pagesave të përdoruesit të shërbimeve të pagesave.


- Ofruesi i shërbimit të informimit të llogarisë (AISP), paraqet një pamje të konsoliduar mbi gjendjen financiare të përdoruesit të shërbimeve të pagesave.

PËRFITIME NGA OPEN BANKING

- Reduktim i kostove
- Informacion i centralizuar
- Akses në një gamë më të gjerë të shërbimeve financiare
- Eksperiencë më e mirë dhe personalizim i shërbimeve të ofruara për klientët, pasojë e rritjes së gamës së ofruesve të shërbimeve në treg
- Rritje e kontrollit dhe sigurisë së të dhënave financiare, nëpërmjet kërkesave për autentifikimin dhe standardeve për bankingun e hapur
- Nxitje e inovacionit dhe konkurrencës në industrinë bankare, nëpërmjet bashkëpunimit të bankave me kompanitë Fintech
- Administrim i buxhetit dhe analizë financiare, ofruar nga institucione të specializuara
- Pagesa dhe transferta më të thjeshtuara dhe më të shpejta

DISA DISAVANTAZHE TË OPEN BANKING

- Siguria e të dhënave: Open banking bazohet në transferimin e të dhënave bankare ndërmjet kanaleve të ndryshme të informimit
- Besimi i klientëve mbetet i ulët: Open banking është ende në fazat fillestare dhe klientëve iu nevojitet përshtatje me shërbimet e reja të ofruara.



ZGJIDHJE TË MUNDSHME PËR DISAVANTAZHET E OPEN BANKING

Siguria e të dhënave:

- Rregullorja “Për autentifikimin e thelluar të klientit dhe standardet e përbashkëta, të hapura dhe të sigurta të komunikimit” është **neutrale**, si nga pikëpamja teknologjike, ashtu edhe e modelit të biznesit.
- Rregullorja iu lejon ofruesve të shërbimit të pagesës për shërbimin e llogarisë që i ofrojnë një paguesi një llogari pagese të aksesueshme *online*, mundësinë e zgjedhjes midis:
 - një **ndërfaqeje të dedikuar** për komunikimin me ofruesit e shërbimit të informimit të llogarisë, ofruesit e shërbimit të inicimit të pagesës dhe ofruesit e shërbimeve të pagesave që emetojnë instrumente pagese të bazuara në karta; ose
 - përdorimit nga ofruesit e mësipërm të shërbimeve të pagesave, të **ndërfaqeve të përdorura për autentifikimin dhe komunikimin me përdoruesit e shërbimeve të pagesave** të ofruesve të shërbimit të pagesës për shërbimin e llogarisë.
- Në çdo rast, ndërfaqet duhet të ndjekin standardet e komunikimit të aplikueshme në Bashkimin Evropian!!!

Besimi i klientëve mbetet i ulët

- Kompanitë *fintech* dhe bankat duhet të punojnë në drejtim të edukimit të klientëve mbi mundësinë e përdorimit të *Open Banking* dhe përfitimeve që vijnë prej tij.

ZHVILLIMET E TREGUT – HAPAT PËR IMPLEMENTIMIN E OPEN BANKING

- Pas miratimit të rregullores 29/2022, bankat kanë marrë masa për sigurimin e plotësueshmërisë së kërkesave të rregullores.
- Bankat kanë përzgjedhur ofruesit e përshtatshëm për të mundësuar *Open Banking*.
- Disa prej bankave kanë *upgrade* ose janë në proces të *upgrade* të sistemeve të tyre, për t'i përshtatur me kërkesat e *Open Banking*.
- Një pjesë e bankave shprehen se kanë kryer procesin e testimit.

ZHVILLIMET E TREGUT – PROBLEMATIKAT E NDESHURA PËR IMPLEMENTIMIN E OPEN BANKING


Nga komunikimet me bankat gjatë muajit dhjetor 2023, rezultojnë disa pengesa për implementimin e plotë të Open Banking:

- Mungesa e interesimit nga TPP (ofrues të shërbimeve të inicimit të pagesës dhe të informimit të llogarisë)
- Pajisja me certifikatën e kualifikuar për vulat elektronike (QSealC).
- *Upgrade* të sistemeve informatike të bankave për t'u përshtatur me kërkesat e *Open Banking*.

ZHVILLIMET E TREGUT – IMPLEMENTIMI I OPEN BANKING NGA JANARI 2024

Sipas komunikimeve me bankat në fillim të muajit dhjetor 2023, statusi për implementimin e plotë të Open Banking:

Statusi i bankave për implementimin e Open Banking



- Parashikim për të dalë live në 1 janar
- Parashikim për të dalë live në tremujorin I 2024
- Parashikim për të dalë live në fillim të 2025
- Në pritje të certifikatës së kualifikuar për vulat elektronike
- Implementim pas upgrade të sistemit informatik të bankës

SFIDAT E SISTEMIT FINANCIAR PËR IMPLEMENTIMIN E OPEN BANKING

- Bankat, për të konkurruar më së miri me kompanitë *Fintech*, duhet të ndryshojnë filozofinë dhe kulturën e tyre, duke filluar nga përshtatja me mjedisin digjital, por edhe strukturat e tyre organizative.
- Nga ana tjetër, në tregun e pagesave duhet të hyjnë ofrues të shërbimit të inicimit të pagesës dhe të informimit të llogarisë, për të mundësuar implementimin e *Open Banking*.
- Gjithashtu, institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike që operojnë në treg, inkurajohen të konsiderojnë ofrimin e shërbimeve të reja të pagesave (shërbimit të inicimit të pagesës dhe të informimit të llogarisë).
- Duhet t'i kushtohet rëndësi administrimit të rreziqeve dhe sigurisë së ofrimit të shërbimeve për klientët, veçanërisht në drejtim të mbrojtjes së të dhënave të tyre.
- Është i nevojshëm edhe edukimi financiar i klientëve për përdorimin e *Open Banking*, si dhe për përfitimet që vijnë prej tij.

PERSPEKTIVA PËR IMPLEMENTIMIN E OPEN BANKING GJATË VITIT 2024

- Banka e Shqipërisë pret që bankat të përfundojnë sa më parë *upgrade* të nevojshme në sistemet e tyre informatike, si dhe të pajisen me certifikatat e kualifikuara për vulat elektronike, për një implementim të plotë të kërkesave të rregullores 29/2022.
- Inkurajohet të rritet interesimi nga institucione të pagesave dhe të parasë elektronike, për të ofruar shërbimin e inicimit të pagesës (shërbimi nr.7) dhe/ose shërbimin e informimit të llogarisë (shërbimi nr.8), me qëllim vënien në funksionim të *Open Banking*.
- Subjektet inkurajohen të informojnë klientët e tyre mbi përdorimin e *Open Banking* dhe përfitimet që mund të marrin prej tij.



JU FALEMINDERIT PËR VËMENDJEN!